



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 nëntor 2012
Nr. ref.: RK320/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI53/12

Parashtrues

Aziz Amrushi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së Punës dhe
Mirëqenies Sociale, të 23 shkurtit 2011, me të cilin parashtruesit i mohohet
pensioni i invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues i kërkesës është Aziz Amrushi nga Pjetershtica, komuna e Shtimes. Parashtruesi është i papërfaqësuar.

Objekti i çështjes

- Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është pretendimi i parashtruesit se vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i 23 shkurtit 2011, përkitazi me kërkesën e tij për të drejtën në pension invalidor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte nxjerrë në mënyrë të gabuar.

Vendimi i kontestuar

- Vendimi që kontestohet është vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i 23 shkurtit 2011, me të cilin parashtruesit i mohohet pensioni invalidor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Baza juridike

- Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 28 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

- Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 21 maj 2012.
- Më 4 korrik 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović (anëtarë).
- Më 3 gusht 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për pranimin e kërkesës.
- Më 22 gusht 2012, kërkesa iu komunikua Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale.
- Më 19 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve të rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi

- Parashtruesi ishte pjesëtar i UÇK-së gjatë trazirave në Kosovë në vitet e 90-ta dhe ishte i plagosur gjatë konfliktit. Për këtë ofroi prova nga Shoqata e Invalidëve të Luftës e UÇK-së. Ai paraqiti kërkesë për pension invalidor të UÇK-së në Departamentin për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Vendimi i Ministrisë, i 23 shkurtit 2011, ia mohoi të drejtën në pension, si invalid i UÇK-së. Në vendim thuhej që parashtruesi kishte të drejtë të ushtronte ankesë kundër këtij vendimi në afatin kohor 15 ditë nga dita e pranimin. Ankesa duhej t'i drejtohej Sektorit për ankesa të Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile.
- Parashtruesi nuk ka ofruar prova që ka ushtruar ankesë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në

Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

14. Neni 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

15. Në këtë rast, nuk ka prova që parashtruesi ka bërë përpjekje për të ushtruar ankesë kundër vendimit të kontestuar dhe prandaj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
16. Siç u tha në Rastin Nr. KI.41/09, Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës (Aktvendimi Nr. RK04/10 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 27 janarit 2010), Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës), është që t’ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999*). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite, ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004*).
17. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme mbi bazën se parashtruesi ka dështuar t’i shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47.2 të Ligjit dhe të rregullit 36.1 b) të Rregullores së punës.
18. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 19 shtator 2012, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani